



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 155, Datë 28.05.2026

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 171, DATË 31.07.2025  
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “EZ-5 ENERGY” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME  
KAPACITET TË INSTALUAR 30 MW”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.05.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1701 prot., datë 26.05.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 171, datë 31.07.2025 “Mbi licencimin e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 30 MW”, i ndryshuar”,

**Konstatoi se:**

**1. Të dhëna mbi shoqërinë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k.**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 171, datë 31.07.2025, ndryshuar me vendimin nr. 280, datë 06.11.2025, vendosi të licencojë shoqërinë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet prodhues 30 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.
- Në pikat 3 dhe 4 të këtij vendimi përcaktohet se shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 31.12.2025 dhe të depozitojë në ERE testimin e veprës jo më vonë se 60 ditë nga ky fakt. Ndërsa në pikën 5 përcaktohet se ky vendim është objekt rishikimi në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve në pikat 3 dhe 4.

**2. Analiza ligjore dhe vlerësimi**

- Afati për vënien në operim të centralit brenda datës 31.12.2025 është përcaktuar duke iu referuar parashikimeve të vetë shoqërisë, ndërkohë që me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 176 datë 15.01.2026, shoqëria ka bërë me dije se është pajisur me lejen e ndërtimit dhe parashikon se punimet për ndërtimin e centralit do të fillojnë më datë 29.01.2026.
- Referuar pikës 1, gërma d) të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 244, datë 30.04.2025 dhe nenit 9 të Kontratës nr. 4456 rep., nr. 2040 kol., datë 27.05.2025, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), të depozituara nga shoqëria në kuadër të licencimit, përcaktohet se, *impianti fotovoltaik duhet të fillojë operimin brenda datës*

30.04.2028. Shoqëria është brenda këtij afati, ndaj vlerësohet që dhe afati i pikës 3 të vendimit të jetë në përputhje me këto akte.

### 3. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### Vendosi:

1. Miratimin e një ndryshimi në vendimin e bordit të ERE-s nr. 171, datë 31.07.2025, i ndryshuar, si vijon:
  - a) Pika 3 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 171, datë 31.07.2025, i ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

*3. Shoqëria të fillojë operimin/ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 30.04.2028.*
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a., shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. dhe shoqërinë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike” (ALPEX) sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**